Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/ Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

- **PUNIME GËRMIMI BAZAMENTI**

Gërmimi i bazamentit realizohet me krah dhe dherat e dala nga gërmimi evadohen me karro dore deri tek porta e hyrjes, ku më pas ngarkohen mbi mjetin e transportit.

Tabani i themelit, kontrollohet ne prezencë të inxhinierit të zbatimit dhe mbikëqyrësit, para se të vazhdohet me fazat e tjera të ndërtimitin të themelit.

Tabani ngjeshte para shtrimit me cakell 20 cm dhe betonimit te bazamentit.

- **PUNIME BETONI DHE HEKUR/BETONI**

Betoni i derdhur në vend do të zbatohet për struktura beton/arme që realizohen duke filluar nga

Themel betoni C 25/30 ne formen e pllakës me h= 50cm

Kolonat (25x25) cm me beton C 25/30

Trare te derdhur ne vend me beton C 25/30

Solete monolite betoni te armuar, beton C 25/30

Lloji dhe klasa e çimentos duhet të jetë, jo më pak se 42.5 R për beton strukturor

Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë.

Per punime të tjera betoni jo strukturor,(shtresa/suvatime), çimento do te jete M 32.5 R.

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë,granil, në raporte të caktuara (*inerte lumore ose frontoje*).

Furnizimi në objekt shoqërohet me certifikatat përkatëse nga prodhuesi mbi karakteristikat e mbushësve.

Hedhja e betonit ne objekt realizohet me shtresa dhe vibrim me ngjeshjen maksimale

Betoni i gatshem në betoniera ose makineri duhet përmbushë kushtet që betoni duhet te derdhet ne vend brenda 90 minutave të prodhimit nëse temperatura e ajrit është më pak se 30 gradë Celsius dhe mund të ulet koha e hedhjes ne objekt deri në 60 minuta nëse temperatura e ajrit është më e lartë se 30 gradë Celsius

Në qoftë se betoni furnizohet i parapërgatitur nga nyjet e betonit do të shoqërohet nga prodhuesi edhe me faturen përkatëse, ku shënohen:

Raporti ujë/çimento është sipas markës.

Uji shtesë mund të hidhet tek betoni nëse raporti maksimal ujë-çimento nuk kalohet. Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë i pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argjila, vajra si dhe substanca të tjera organike.

Në përgjithësi, uji i tubacioneve të ujesjellesit afer nenstacionit Shumat është i pijshëm dhe rekomandohet njëkohësisht edhe për përdorim të prodhimin e betonit.

Betoni nuk hidhet ne objekt, nëse kushtet atmosferike nuk jane te pershtatshme, sic janë rastet e temperaturave ekstreme (të larta ose te ulta) apo kur struktura është e pambrojtur nga rreshjet intensive të shiut.

Rekomandohet betonimi deri ne 10 gradë celsius, si minimum i temperaturës se ambientit gjate betonimit dhe jo mbi 32 ° celsius

Para se të derdhet betoni në vend, pastrohet siperfaqja dhe laget njëkohësisht.

Betoni nuk duhet të lejohet të bjerë i lirë nga një lartësi më e madhe se 3m, por i organizuar me ulluqe metalike afer siperfaqes qe betonohet

Strukturat si me siper krahas derdhjes se betonit sipas markes se parashikuar ne projekt-zbatimin, perfshijnë edhe kallepet, perforcimet, skelat e sherbimit.

Shtresat niveluese te betonit jane C 12/15

Hekur betoni

Hekuri furnizohet ne objekt i shoqëruar me çertifikatën e prodhuesit për të verifikuar që çeliku plotëson kushtet e kërkuara ne projektin e zbatimit

Përgatitja e çelikut për të gjitha strukturat e betonit duhen prodhuar në kantier,

Kthimi i hekurit duhet të realizohet sipas dimensioneve te treguara ne projekt. Lidhja realizohet jo me saldim por me tel bari Ø1,25 mm

Vendosja dhe fiksimi i hekurit do te pozicionohen siç jane paraqitur ne projekt dhe do te ruajne kete pozicion edhe gjate betonimeve.

Shtresa mbrojtese e betonit per hekurin nuk duhet te jete me pak se 2.5 cm dhe kjo realizohet me perdorimin e distancatoreve

Hekurit ne kantier duhet të jetë stivosur, qe te mos demtohet dhe me masa mbrojtëse ndaj ndryshkut

- **MURATURA ME TULLA**

Tulla si element i ndertimit duhet te plotesoje kushtet e meposhtme per ndertimet antisizmike: Rezistencen ne shtypje, e cila duhet te jete per tullat me vrima 80 kg/cm²; Rezistencen ne prerje, e cila duhet te jete: per te gjitha tullat me brima 20 kg/cm²-

Perqindja e boshlleqeve, e cila duhet te jete: per tullen e plote 0-25 %; dhe per te gjitha tullat me brima 25- 45 %

Trashesia e paretit perimetral dhe te brendshem per tullat e plota, te mos jete me e vogel se 20 mm dhe per te gjitha tullat me brima, trashesia e paretit perimetral te mos jete me e vogel se 15 mm dhe e paretit te brendshem, jo me e vogel se 9 mm. Siperfaqja e nje boshlleku (vrime) te mos jete me e madhe se 4.5 cm².

Ujëthithja në përqindje duhet te jete nga 15 – 20 %.

Mur me tulla te lehtesuara

Murature me tulla te lehtesuara, ne lartesi deri 3 m, realizohen me llaç bastard m-25.

Normativat per 1 m³:

- tulla te lehtesuara nr. 205 cope/m³,
- llaç bastard 0.29,
- çimento 42.5 R,

Per muraturen e katit perdhe, siperfaqja e xokolit duhet te jete e niveluar me nje shtrese llaçi çimento 1:2, (çimento 527 kg/m³) jo me te vogel se 2cm, për shmangjen e kapilaritetit drejt muratues së tulles.

Per të dyja tipet e mureve, t= 25 dhe t=10 cm në procesin e muraturës, përfshihen skelat e sherbimit

• **SUVATIMET E BRENDSHME, TË JASHTME DHE PATINIMI**

Suvatim i brendshem

Bëhet sprucim i mureve dhe tavaneve me llaç çimentoje te lenget, per permiresimin e ngjitjes se suvase dhe rforcimin e siperfaqeve te muratures,

Suvatim është një shtresë me trashesi 2 cm llaçi bastard m-25 me permban per m²:

rere e lare 0,005 m³; llaç gelqereje m- 1: 2, 0.03 m³; çimento 32.5 R- 6.6 kg; uje,

Suvatimi aplikohet me paravendosje te drejtuesve ne mure (*shirtit me llaç me trashesi 15 cm çdo 1 deri ne 1,5 m*), me fërkim me mistri e mallë përdafi

Suvatimi perfshin edhe skelat e sherbimit.

Shtresat

Shtresa paraprake niveluese C 12/15, vendoset mbi shtresen e izolimi me MAPEI.

Shtresa e pllakave te dyshemese eshte grez (ose porcelanato), cilesia e I, importi , CE.

Plintuset jane idem materiali i pllakes grez (ose porcelanato). Per fugat bojaku eshte cilesia.

Patinimi

Patinatura e mureve të brendshme realizohet me stuko të cilesise se larte, mbi siperfaqe te suvatuara me pare dhe te niveluara,

Patinatura konsiderohet e perfunduar dhe e gatshme per t'u lyer me çdo lloj boje, kur siperfaqja eshte e sheshtë dhe kur nuk ka ka gervishtje

Lyerje me boje plastike

Te gjitha bojrat qe do te perdoren duhet te zgjidhen nga nje prodhues qe ka eksperience ne kete fushe.

Nuk lejohet perzierja e dy llojeve te ndryshme markash boje gjate proçesit te punes. Hollimi i bojës duhet te behet vetem sipas udhezimeve te prodhuesit dhe aprovimit te Supervizorit.

Perpara fillimit te punimeve, kontraktori duhet t'i paraqese per aprovim Supervizorit, marken, cilesine dhe katalogun e nuancave te ngjyrave te bojës, qe ai mendon te perdore.

Furçat, kovat dhe enet e tjera ku mbahet boja duhet te jene te pastra.

Veshje fasade me polisterol, cilësia I, kompakt (90 kg/m³) me t= 8 cm

Veshje fasade me sistem izolimi termik “**Kapotë**”, përfshin zbatimin me të gjitha komponentët të të gjitha materialeve dhe përbërësit e nevojshëm :

-shtresa bazë e suvatimit,

-llaçi ngjitës kolla,

-veshja me polisterol jeshil kompakt 30 kg/m³, cilesia I

-llaç zbutës,

-rrjetë për përforcim,

-shtresë e suvatimit grafiato etj).

Këto materiale duhet të jenë në përputhje me certifikimet ISO 9000/14000 (UNI-EN 29000/UNI-EN 14000) dhe me markim CE.

Para aplikimit te grafiatos fasada duhet te jete e pastruar nga llacerat dhe pluhurat.

Grafiatoja e gatshme eshte në thasë 15-25 kg ne trajten e pluhurit i cili perzihet me uje derisa formohet nje mase homogjene lehtesisht e aplikueshme.

Para aplikimit te grafiatos, vendoset paragrafiato e cila duhet te jete mire e sheshuar dhe e niveluar dhe menjehere pas aplikimit te produktit ne fasade, behet rrafshimi i tij me nje malle plastike dhe punohet ne drejtim vertikal.

Gjate aplikimit te produktit duhet patur parasysh qe temperatura e ambientit te jete me e madhe se 5 °C.

Ne prani te temperaturave te larta produkti mbas aplikimit duhet te sperkatet me uje per te menjanuar humbjet e lageshtise optimale

Suvatimi grafiato me trashesi 3 mm ka dozimin 5kg/1m²

- **PUNIME ELEKTRIKE + KOINDICIONIMI + SINJALIZIMI + TELEFONIA**

Te gjithë materialet dhe aparaturat duhet tu përgjigjen normave te CE. Rekomandohet ne zgjedhjen e materialeve, preferenca e prodhimeve evropiane

Tubat mbrojtës dhe kutite shperndarëse-

Tubat duhet t'ju rezistojnë veprimeve mekanike, gërryese, termike ose lagështisë dhe agjenteve te tjerë ndaj te cilëve mund te ekspozohen gjate punës..

Tubat mbrojtës duhet te jene me material termoplastik për kalimet nën dysheme.

Diametri i brendshëm i tubave duhet të jetë të paktën 1,3 herë diametrin e rrethit të jashtëshkruar tufës së përcjellesave të futura në të dhe nuk duhet të përmbajë kabllot monitorimi të dhenash dhe të telefonisë.

Diametri i tubit duhet të lejojë lehtësisht futjen dhe nxjerrjen, lehtësisht të të tufës së përcjellësve.

Në çdo kthese rakordimi të fortë është e nevojshme struktura mbrojtëse.

Bashkimet e përcjellësve duhen të kryhen në kutitë e degëzimit (shpërndarjes) duke përdorur morsetat shtrënguese. Kutitë e shpërndarjes (degëzimit) duhet të jenë të tilla që gjatë instalimit të mos jete e mundur ndërhyrja e trupave të huaj dhe të kryhet shpërndarja e nxehtësisë që prodhohet në to.

- Kabllo dhe përcjellesa –

Seksioni i përcjellësve të instalimeve të brendshme është zgjidhur sipa rrymës së lejuar dhe fuqisë së instaluar (deri 5 kW).

Për ndriçim përdoren përcjellës me seksion 1,5 mm², ndërsa pajisjet furnizohen me përcjellës 2,5 mm². Ushqimi kryesor në godinë realizohet me kabllo fuqie me seksion (3x4) mm².

Prizat dhe celesat vendosen në lartësi 90-120 m nga dyshemeja

Burimi i ushqimit të vendrojes, realizohet nga nevojat vetiake të Godines së kontroll-monitorimit të nenstacionit Shumat. Objekti tokezohe.

Në pjesën jugore instalohet pajisja koindicioner me kapacitet 9 Btu, të tipit : *Kondicioner, TCL, 9000 BTU, Inverter, A++/A+*

Kabllot e telefonise dhe kompjuterit futen ne tubin korrugato 18-21 mm

Sinjalizimi i personelit te rojeve behet me zile elektrike dhe telefonin e brendshem

• PUNIME MBULIMI ME ÇATI ME TJEGULLA

Konstruksioni kryesor mbajtës i çatisë me dru pishe të stazhionuar në mënyrë natyrale ose artificiale, imprenjuar me vaj të djegur dhe materiale septike për insektet të përshtashëm për lëndën e drurit. Kontrukcioni mbajtës prej druri i çatisë dhe vënë në vepër mbi mbështetje dërrase ankoruar në brezin e soletës monolite, skuadruar në seksione gati uniforme, duke përfshirë fiksimin e madh për të lidhur çatinë me muret dhe hekurin e nevojshëm të stafave lidhëse.

Elementët e tjerë mbajtës të çatisë në dru pishe të stazhionuar në mënyrë natyrale ose artificiale, imprenjuar me vaj të djegur janë ristelat ose dysheme dërrase ku montohet mbulesa me tjegulla të tipit “Marsigliese” të reja të gozhduara ose të lidhura.

KUlmet e gatshme të çatisë për mbrojtjen unifikimin e mbulesës me tjegulla lidhen me të me llaç bastard m- 25 Ketu p[er]fshihen edhe skelerite për realizimin e çatisë

Ulluqet horizontale realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Cdo ulluk horizontal mbulon gjysmen e sipërfaqe (dy pjerres, nga 4 pjesë) Ulluqet horizontale prodhohen me

material plastik me b= 33 cm ose me llamarinë zinkato. Ulluku me llamarinë prej çeliku të zinkuar me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, e

modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vendosura cdo 70 cm.

Ulluqet vertikale prej PVC kanë dimensione nga 8 deri në 12 cm dhe mbulojnë gjithë sipërfaqen e catise (normtiva për 1 ulluk=nga 30 deri në 60 m²). E gjithë sasia e rreshjeve

mbi sipërfaqen e catise perballohet nga dy kaseta shkarkimi dhe dy ulluqe vertikal te vendosura diagonal ne qoshet e kunderta te catisë.

Ullukët vertikale vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës dhe fiksohen me ane te qaforeve përkatëse prej çeliku të xinguar, të fiksuara çdo 1.5 m.

Pjesa fundore e ulluqeve, për lartësinë 2 m, duhet të jetë PVC dhe e mbërthyer me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehet me bërryl 90°.

Vetrata + Dyer+ dritare duralumini

Vetrata +dyer + dritare janë prej prej duralumini dopio xham. Vetratat do te te jenë me dy korniza fikse ose te levizshme jane projektuar dhe jane bere me dy profile alumini te cilat jane bashkuar me njera tjetren dhe kane nje fuge ajri qe sherben si thyerje termike,. Fiksimi i tyre me kontrotelajo do te behet me kujdes me fashetat e hekurit tek kollonat (vetrata) dhe tek muri me llaç (dyert dhe dritaret). Vendosja e tyre perfundimtare me strukturen me telajon kryhen pas perfundimit te suvatimit dhe bojatisjes. Kanate te hapshem me xhama do te vendosen me mentesha ne skeletin e vetrates dhe do te pajisen me brave mbyllese dhe doreze. Ngjitja dhe mbushja midis kasave dhe mureve do te kryhet duke perdorur materiale elastiko-plastike, mbas mbylljes se çdo te çare me materiale izoluese. Midis brendesise se kornizes suportuese dhe kornizes se jashme fikse te aluminit ruhet nje tolerance instalimi prej 6mm.

Panelet e xhamit do te jene te fiksuara ne skeletin metalik me ane te listelave te aluminit ne profilet metalike dhe te shoqeruara me gomina.

Toleranca dimensionale dhe trashesia do te jene sipas standarteve Europiane

- **Furnizimi me uje**

Tubat e ujit te pijshem do te jene te tipit PP-R (polipropilen). Nga pika e lidhjes deri tek objekti do jenë tuba me Ø 32 m



Per te shmangur fenomenin e bymimit dhe tkurrjes te tubove PP-R nga diferenca e temperaturave (*temperatures se jashtme dhe temperatures se ujit qe rrjedh*) tubacioni futet ne kanal me h-40 cm, pergjate murit te rrethimit.

Rritja e presionit e ujit sanitar realizohet me pompen me pulmon qe instalohet prapa godines

Pajisjet hidrosanitare

Sipërfaqja e hapsirës së tualetit është $(1.05 \times 1.05) m$ dhe mund të instalohen një WC- allafrenga dhe një lavaman. Pajisjet janë prej material porcelani me të dhënat e standarteve teknike nderkombetare.

WC është me dalje anesore dhe tubi i daljes duhet të jetë në lartësi 19 cm nga dyshemeja.

Lavaman lidhet me tubin e shkarkimit të ujërave me anë të piletes, tubit në formë sifoni prej materiali PVC-je.

Per ujin e ngrohte sanitar instalohet një boiler me $C \leq 50$ litra

- **Shkarkim i ujit të përdorur, depozitimi dhe kanali i ujërave të zeza**

Per shkarkimet e ujërave brenda ambienteve do të përdoren tuba plastike polipropilen të termostabilizuar në temperatura të larta që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësive sipas standartit EN 1451.

Keto tuba duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjenteve kimike dhe mundësi të thjeshta riparimi.

Rakorderite për lidhjen e tubave të shkarkimit me njëri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të jenë prej material plastik RAU – PP, që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësive sipas standartit EN 1451 . Rakorderite duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike,

Per organizimin e rrjedhjes së ujërave të zeza do të përdoret një pusëtë edhe në funksionin e kolektorit (t a n k e r) $(1.75 \times 1.75 \times 1.5) m$ b/arme të papershkueshëm nga uji dhe mbyllur me kapak gize ose me kapake betoni të armuar, $t= 10-15$ cm. Forma e ndertimit të tyre është katrore ose rrethore.

Per shkak të kushteve të vecanta, kjo pusëtë, do të ketë funksionin edhe si depozitë septike që pastrohet herë pas here, si dhe me shkarkim në piken fundore të lidhur me tubin e shtrirë në kanal të shkarkimit të ujërave të zeza (ana e perroit).



Tubi i shkarkimit ne dalje te kolektorit ne kanal është i tipit plastik korrugato Ø 150-170 mm

A. SHELTERAT (KABINA VENDROJE) NE N/STACIONE

• PRODHIMI I SHELTERIT

Shelteri do te jete konstrukcion metalik (2.44x2.44x2.59)m me karakteristikat, si me poshte :

- **Baza:** llamarine e lyster, boje e pjekur e punuar sp 1.8 mm,
- Ulluku I shkarkimit: llamarine e lyster, boje e pjekur, e punuar sp 1.8 mm
- Kollonat: llamarine e lyster, boje e pjekur e punuar sp 1.8 mm, h = 2.59
- Muret (paretet) - , panel sandwich me mbushje Polyurethane (PUR) me trashësi 8-10cm, me dendësitet 40kg/m³, të lyster në nuancën electrostatike RAL 9002
- Mbulesa: panel sandwich me mbushje Polyurethane(PUR) me trashësi t=10 cm, me 5 kreshta, dendësiteti 40kg/m³, të lyster në nuancën electrostatike RAL 9002
- Muret jane te veshura nga brenda me material MDF
- Dyshemeja eshte konstrukcion metalik zinkato me nje shtrese paneli 30 mm per termoizolim ku mbi te vendoset derrase e presuar novopan 18mm, kunder ujit , hidroizolues dhe termoizolues



Mbi derrase vendoset linoleum industrial

- **Dyer/dritare** - Ne njëren faqe do të kete - **1 derë d/al** me ½ mbushje (90x210) cm, dopio xham + 1 dritare duralumin dopio xham me rreshqitje - (Dera + dritare, jane te tipit "flamur")- shih skicat
- Vetratat – jane në ne tre faqet e tjera. Do te jene statike (te pahapshme), duralumin dopio xham. Panelet e xhamit do te jene te fiksuara ne skeletin metalik me ane te listelave te aluminit ne profilet metalike dhe te shoqeruara me gomina.
- Toleranca dimensionale dhe trashesia do te jene sipas standarteve Europiane

Prodhimi sipas normave standarte

- Sistemi elektrik -Sistem elektrik deri ne dalje te konteinerit, 3 priza + 1 celes + 1 llampe

Ne prodhimin e shelterit perfshihet edhe f.vendosja e nje koindicioneri 7000 btu



- **VENDOSJA E SHELTERIT (Vendroja)=**

Vendoset afer rrethimit te nenstacionit ne pozicionin e percaktuar nga specialiste e sherbimit te sigurise me qellim zgjerimin e fushepamjes se monitorimit nenstacionit TL, rreth 360 °.

- **PUNIME BETONI DHE HEKUR/BETONI/ SHELTERAT**

Shelteri (container) – (2.44x2.44x2.6) m montohet me vinc (dy vinca) mbi nje pllake b/arme (3x3x0.17) m, beton C 25/30, armuar me nje zgare hekuri periodik Ø 8 mm me kuadrate per moslejimin e plasaritjes se betonit.

- **Sigurimi në punë**

Specialistët do të pajisen me dorashka dhe veshje te posacme.

Punëtorët dhe specialistet do të pajisen me mjetet mbrojtëse kolektive.

Në mjedisin e punës do të jetë kutia e ndihmës së shpejtë e pajisur rregullisht me materialet e dezinfektimit dhe barnat e tjera te nevojshme ne raste emergjente.

Personeli i zbatimit te punimeve brenda nenstacionit, duhet te instruktohet edhe per masat mbrojtese ne territorin e energjizuar te nenstacionit.

- **E pergjithshme**

Punimet e ndertimit te objektit zbatohen dhe mbikeqyren ne zbatim te ligjit 8402, dt. 10.09.1998 ''Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit'' (I ndryshuar) dhe nr. 610, datë 22.9.2022 ''për përcaktimin e rregullave të detajuaraprocedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve''.

Pas perfundimit te punimeve sheshi i ndertimit pastrohet nga materialet e mbetura dhe sistemohet sheshi dhe hapësirat e tjera ku jane kryer punimet e ndertimit.

Shënime:

- Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".**
- Kudo ne Specifikiet Teknike ku eshte cituar standard nderkombetar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

-
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 900,000 (nenteqind mije) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën:*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 700,000 (shatëqind mijë) Leke dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më të vogël se 2,400,000 (dy milion e katërqind mijë) Leke.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorite e meposhtme:*

Punime te pergjithshme ndertimi:

Kategoria NP-1	Punime germimi ne toke	Klasifikim A
Kategoria NP-2	Ndertime civile dhe industriale	Klasifikim A

Shenim: Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale duhet te kete te punesuar te pakten 1 (një) teknik ndërtimi dhe 1 (një) inxhinier ndërtimi/hidro.*

Punonjesit e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Lidhur me kete pikë operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperm, certifikimet e punonjesve, deshmi IQT, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te dëshmoje se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 3 (tre) punonjës (kategori I), 2 (dy) punonjës (specialist-karpentier-betonist), 1 (një) punonjës (elektricitist), me kohë të plotë pune për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listepagesat perkatese E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 3 (tre) punonjes, te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik.*

Lidhur me kete pike, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

- i. Listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar si dhe*
- ii. Kartelat perkatese te vlefshme te sigurimit teknik.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues per përmbushjen e kontratës duhet te dëshmoj se ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme, si me poshte vijon:*

Nr.	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti deri ne 7 ton (germime + materiale ndërtimi)	1 cope
2	Autovinc deri ne 5ton (montimi i shelterave)	2 cope
3	Betoniere	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:

- 1. Per mjetet në pronësi te paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)*
- 2. Per mjetet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit te bere me lart.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe kane lidhje me objektin e prokurimit, si me poshte:*

- ✓ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.*
- ✓ ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurise ne pune.*
- ✓ ISO 14001: per Sistemin e menaxhimit mjedisor.*

2.3.8 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise, perfshire ato teknike.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim:

- Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*
- Ne plotesimin e “Formularit permbledhes te vetedeklarimit”, ne piken “Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, OE ofertues duhet te shenoje ne menyre te sakte, si prove paraprake: degen e studimeve te punonjesive, si dhe profilet perkatese te diplomave, qe disponon per plotesimin e kriterave te vecanta te kualifikimit. Keto deklarime do te shqyrtohen kur OE ofertues do te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara per punonjesit, pas shpalljes fitues se ofertes. Keqinformimi dhe deklarimi i rreme me qellim kualifikimin e ofertes, ne menyre te padrejte, sanksionohet nga pika 1/a, te nenit 78 “Perjashtimi per nje periudhe te caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.*

Shtojca 8.**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e</p>

ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
